



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 25.11.2019, ora 11:10

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutim nen për nen i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Anduel Xhindi, Luan Harusha, Elona Gjebrea, Luan Duzha, Xhemal Qefalia, Lefter Maliqi, Edmond Rrushi, Edmond Stojku, Elena Xhina, Myslim Murrizi.

Mungojnë:

Arben Elezi, Alban Zeneli, Ylli Shehu, Paulin Sterkaj, Artemis Dralo, Antoneta Dhima, Nimet Musaj.

Të ftuar:

Petro Koçi - Zëvendësministër i Mbrojtjes

Julian Hodaj - Zëvendësministër i Brendshëm

Ylvi Aga - Shërbimi Informativ i Shtetit

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Hapim mbledhjen e Komisionit parlamentar për Sigurinë Kombëtare. Pasi kemi dëgjuar të gjitha institucionet që janë në fushën e përgjegjësisë së këtij komisioni për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”, si dhe pasi kemi hartuar raportin për të gjitha kërkesat në parim që të gjitha institucionet qendrore të sigurisë dhe të mbrojtjes i kanë paraqitur këtij komisioni, sot duhet të miratojmë nen për nen projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”, me qëllim që t’i japim mundësi Komisionit për Ekonominë dhe Financat, i cili është komision përgjegjës për shqyrtimin e këtij projektligji, të reflektojë të gjitha kërkesat që kemi diskutuar së bashku në mbledhje të veçanta me çdonjërin prej institucioneve të sigurisë dhe të mbrojtjes.

Meqenëse kemi vetëm miratimin nen për nen dhe në tërësi të këtij projektligji, ne i kemi ftuar të gjithë përfaqësuesit e institucioneve që të jenë prezentë. Nga Ministria e Mbrojtjes kemi të pranishëm zotin Petro Koçi, zëvendësministër i Mbrojtjes, nga Ministria e Brendshme zotin Julian Hodaj, zëvendësministër i Brendshëm, nga Shërbimi Informativ i Shtetit kemi zotin Ylvi Aga. Faleminderit të ftuarve për pjesëmarrjen!

Nuk e di nëse zoti Laknori është prezent?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Përfaqësuesit e institucioneve janë prezentë, kështu që, pa humbur kohë, vazhdojmë me votimin nen për nen të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”.

Kush është dakord me nenin 1 të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”, i cili është i përbërë nga të ardhurat, shpenzimet dhe deficitit? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2 të projektligjit? Projektligjin e keni përpara, kështu që mund të ecim paralel. Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3 të buxhetit? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Neni 4. Kush është dakord me buxhetin e sigurimeve shoqërore për vitin 2020? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5 bën fjalë për buxhetin e sigurime shëndetësore për vitin 2020. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6. Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të pronarëve për vitin 2020. Kush është dakord me këtë nen? Faleminderit! Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 6.

Neni 7. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 7.

Kalojmë te kreu II i projektligjit, “Burimet për mbështetjen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit”.

Neni 8. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 9, ku bëhet fjalë për kufirin e financimit të deficitit të buxhetit të shtetit. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 10, që është pjesë e kreut III dhe bën fjalë për shpenzimet e buxhetit të shtetit dhe mënyrën se si ndahen ato. Kush është dakord me nenin 10? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 10.

Neni 11 bën fjalë për numrin e përgjithshëm të punonjësve buxhetorë, që shkon në 82 mijë e 377. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 12, ku bëhet fjalë për pagën e Presidentit të Republikës, që është e njëjta në çdo ligj që kemi kaluar për buxhetin. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 12.

Neni 13, ku bëhet fjalë për fondin rezervë të buxhetit të shtetit dhe mënyrën se si përdoret ai. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 14, ku bëhet fjalë për transfertën e pakushtëzuar, që buxheti qendror ia transferon pushtetit vendor. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 15, “Fondet e buxhetit të shtetit për arsimin e lartë”. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 16. Edhe në këtë nen bëhet fjalë për kufirin e shpenzimeve, që mund të rishpërndahet brenda programeve që parashikohen për vitin që vjen. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 17, ku bëhet fjalë për tavanin e vlerës totale të kontratave në përqindje të produkti të brendshëm bruto për të gjitha projektet koncensionare. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 17.

Në fakt, shumica dërrmuese e neneve, që përmban në parim ligji, lidhen specifikisht me buxhetin për institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes, të cilat ne i trajtojmë në komisionin tonë.

Neni 18. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 18, që bën fjalë për stokun e borxhit të qeverisjes.

Neni 19 flet për rastin e emetimit të një eurobondi të ri.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20 përcakton Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë si ministri përgjegjëse për të nxjerrë të gjitha udhëzimet në zbatim të këtij ligji.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21 “Hyrja në fuqi e ligjit”, është parashikuar të jetë në afatin e zakonshtëm, ndërkohë që të gjitha efektet financiare që parashikon ky ligj do të fillojnë nga data 1 janar e vitit 2020, pasi projektbuxheti të ketë kaluar në parim dhe nen për nen në seancë plenare.

Për sa u takon institucioneve të sigurisë dhe të mbrojtjes, dua t’ju them se nga fjala juaj nënkuptuam se buxheti që u është akorduar këtyre institucioneve shkon paralel me përmbushjen e objektivave nga ana e tyre. Disa kërkesa të vogla që kanë pasur institucionet, si SHISH-i, Komisioni i Jashtëm për Rivlerësimin Kalimtar të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe të SHÇBA-së janë marrë parasysh nga ana jonë. Këto janë reflektuar edhe në raportin që do t’i çojmë Komisionit të Ekonomisë.

Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Duke ju falënderuar edhe një herë për kalimin në parim dhe nen për nen të buxhetit, do të doja që në raportin tuaj drejtuar Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të theksohet fakti se Ministria e Mbrojtjes kërkon që te zërat përkatës, ku përfshihen forcat e luftimit dhe të arsimimit ushtarak, të bëhet një kalim i vogël. Pra, nga forcat e luftimit te arsimimi ushtarak. Shifra do të definohet këto ditë, por do të doja të ishte në raport, për të qenë në vëmendjen e komisionit dhe më pas të seancës plenare.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Ne e diskutuam këtë pjesë edhe gjatë mbledhjes me ju dhe patjetër që do ta reflektojmë në raport, sepse referenca lidhet me përmbajtjen e tabelave që shoqërojnë projektligjin për buxhetin e vitit 2020, ndaj do ta jetë në vëmendjen e komisionit përgjegjës.

Kolegë, kush është dakord me miratimin në tërësi të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ju urojmë të gjithë pjesëmarrësve punë të mbarë!

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA